



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE

Nr. 6/11 prot.
Tiranë, më 23. 11. 2021

Nr. 4787 prot.
Tiranë, më 23. 11. 2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

TRAJTIMIN E PERSONAVE ME ÇRREGULLIME TË SHËNDETIT MENDOR ME MASË MJEKËSORE

Në mbështetje të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të nenit 15, pika 2, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, dhe ligjit nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ranë dakord si më poshtë vijon:

I. OBJEKTI

Objekt i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i angazhimeve dypalëshe nëpërmjet marrjes së masave afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në adresim të rekomandimeve të mekanizmave monitorues ndërkombëtarë dhe kombëtarë, si dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të:

- a) personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor;
- b) të burgosurve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor;
- c) personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm.

II. ANGAZHIMET E MINISTRISË SË DREJTËSISË

1. Ministria e Drejtësisë merr përsipër:

- a) vendosjen në dispozicion të pajisjeve që disponon, me qëllim përshtatjen dhe pajisjen me aparaturat e nevojshme të dy godinave pranë Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë,

duke siguruar mjedis fizik të përshtatshëm për ofrimin e kujdesit terapeutik, human dhe të sigurt për personat me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore, sipas përcaktimeve të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012, "Për shëndetin mendor";

b) ofrimin e masave të sigurisë për ruajtjen e këtij institucioni;

c) vazhdimin dhe përmirësimin e kujdesit e të sigurisë nëpërmjet rishikimit të protokolleve dhe procedurave për funksionimin e këtij institucioni transitor dhe trajnimeve të stafit.

III. ANGAZHIMET E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr përsipër:

a) ofrimin e shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve, sipas nevojave;

b) sigurimin e diagnostikimit (ekzaminimeve kliniko-biokimike, imazherike, konsultave të specializuara etj.) dhe trajtimit të specializuar (ndërrhyrje kirurgjikale etj.) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, nëpërmjet Spitalit Rajonal të Lezhës dhe strukturave të tjera spitalore universitare;

c) ofrimin e ekzaminimeve laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë;

ç) planifikimin e ngritjes dhe funksionimit të Institucionit Mjekësor të Posaçëm, si strukturë e posaçme për ofrimin e një kujdesi terapeutik, human e të sigurt, për personat me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore, sipas standardeve ndërkombëtare në këtë fushë.

IV. ANGAZHIMET E PËRBASHKËTA

1. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale marrin përsipër:

a) hartimin e kurrikulave në fushën e psikiatrisë ligjore, procedurave standarde të veprimit të Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë, si një institucion transitor, si dhe të planit të kujdesit të vazhdueshëm në nivel komunitar me daljen e pacientëve nga institucioni dhe trajnimin e stafit të institucionit transitor dhe shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor;

b) transferimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, ndaj të cilëve është vendosur masë mjekësore, nga Institucioni i Kujdesit Shëndetësor Lezhë në Institucionin Mjekësor të Posaçëm, pas krijimit të tij, si dhe informimin e stafit, pacientëve dhe familjarëve për planet e zhvillimit;

c) miratimin e *planit të përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore* sipas tekstit të aneksit

bashkëlidhur kësaj marrëveshje, i cili parashikon aktivitete specifike mbi angazhimet e marra përsipër në këtë marrëveshje.

V. KOMUNIKIMI

1. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, jo më vonë se 5 ditë nga nënshkrimi, caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe planit të veprimit, aneks i kësaj marrëveshje, në nivel zëvendësministri dhe drejtori të përgjithshëm.
2. Pjesë e komunikimit dhe bashkëpunimit midis palëve janë takimet periodike të grupi të punës për ecurinë e zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe planit të veprimit, aneks i kësaj marrëveshjeje.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje i nënshtrohen legjislacionit në fuqi dhe janë brenda kufijve të buxhetit që palët kanë në dispozicion.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me dakordësinë mes palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.
3. Marrëveshja përfundon me realizimin e masave të marra përsipër nga secila palë sipas plani i përbashkët i veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, aneks i kësaj kontrate
4. Çdo mosmarrëveshje, lidhur me interpretimin ose zbatimin, zgjidhet me mirëkuptimin e palëve.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të palëve.

Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Ministrinë e Drejtësisë dhe 2 (dy) në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet sot, në Tiranë, më datë _____.2021.

PËR MINISTRINË E DREJTËSISË

**PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

MINISTRI

Ulsi MANJA

The block contains a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp features the coat of arms of Albania and the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" and "MINISTRIA E DREJTËSISË".

MINISTRI

Ogerta MANASTIRI

The block contains a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp features the coat of arms of Albania and the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" and "MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE".

PLANI I PËRBASHKËT I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE DHE TRAJTIMIT **TË PERSONAVE ME ÇRREGULLIME TË SHËNDETT MENDOR** **ME MASË MJEKËSORE**

Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet zbatuese/bashkëzbatuese
1. MASAT ADMINISTRATIVE			
1.1	Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe planit të përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore	Dhjetor 2021 – në vazhdimësi	MD; MSHMS
1.3	Zbatimi i masave individuale të Vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “Strazimiri kundër Shqipërisë” nëpërmjet transferimit në Institutin e Trajtor Lezhë, si pjesë e grupit të parë të pacientëve të transferuar në këtë strukturë, dhe hartimi i planit individual të trajtimit	Dhjetor 2021	MD
2. INSTITUCIONI TRANZITOR LEZHE			
2.1	Përfundimi i rikonstruksionit të Institutit të Trajtor Lezhë duke siguruar ambient fizik të përshtatshëm për ofrimin e kujdesit terapeutic, human dhe të sigurtë (që adreson akomodimin e numrit aktual të personave me masë mjekësore, që shmanjë mbipopullimin dhe ruar dinjitetin e pacientëve) dhe që ju përjetojnë nevojat gjinore	Nëntor 2021	MD

	dhe moshore të përdoruesve, si dhe të aksesueshmërisë nga personat me aftësi të kufizuara		
2.2	Informimi i stafit, pacientëve dhe të afërmeve dhe transferimi i pacientëve, stafit dhe dokumentacionit nga Institucioni i Veçantë Krujë në Institucionin Tranzitor Lezhë.	Dhjetor 2021	MD
2.3	Pas transferimit të pacientëve, Institucioni i Veçantë Krujë do i nënshtrohet procesit të dezinfektimit për një periudhë 3 mujore	Janar – Mars 2022	MD; MSHMS
2.4	Fuqizim i stafit multidisiplinar i Institucionit Tranzitor Lezhë me qëllim përmirësimin e kujdesit terapeutic	Dhjetor 2021 – në vazhdimësi	MD
2.5	Përditësimi/hartimi i rregullores së funksionimit të Institucionit Tranzitor Lezhë	Dhjetor 2021	MD
2.6	Hartimi : kurrikulës së trajnimit në fushën e psikiatriisë ligjore dhe zbatimi i trajnimeve në vendin e punës, me fokus të veçantë shmanjien dhe menaxhimin e dhunës dhe agresionit, shmanjien e keqtrajtmeve, etj.	Janar – Qershor 2022	MD; MSHMS
2.7	Rishikimi dhe miratimi i Protokollit të Sigurisë në përputhje me udhëzimet evropiane për stafin e sigurisë (aksesin e tyre në zonat e pacientëve, kontakti me pacientët, procedurat e kontrollit, siguria e perimetrit, përdorimi i mjeteve speciale, dokumentimi i ndërhyrjeve, etj)	Dhjetor 2021	MD
2.8	Trajnimi i stafit të sigurisë mbi protokollet e reja	Janar – Shkurt 2022	MD
2.9	Rishikimi/hartimi i procedurave standarde të veprimit të institucionit tranzitor ku të trajtohen qëshijet si: vlerësimi i pacientëve në momentin e pranimit, përfshirë diagnozën dhe rezikun; kujdesi	Janar – Qershor 2022	MD; MSHMS

	shëndetësor fizik dhe ekzaminimi shëndetësor përfshirë edhe ekzaminimet laboratorike dhe imazherike; dokumentacioni klinik, përfshirë planet individuale të trajtimit; ruajtja dhe administrimi i barnave; masat kufizuese që përfshijnë izolimin, kufizimin fizik dhe medikamentoz; kontakti me botën e jashtme si vizitat dhe telefonatat, kujdesi specifik gjinor, moshor dhe për aftësinë e kufizuar, etj)		
2.10	Trajnim i stafit mbi PSY-te dhe supervizimi i zbatimit korrekt të tyre me qëllim ofrimin e një kujdesi terapeutik të sigurtë, pa pasoja negative në shëndetin e pacientëve ose mjedisin e ofrimit të kujdesit, dhe që maksimizon efikasitetin e ndërhyrjeve	Janar – Qershor 2022	MD; MSHMS
2.11	Hartimi i planit të kujdesit të vazhdueshëm në nivel komunitar me daljen e pacientëve nga institucioni (trugë të qarta trajtimi pas daljes nga institucioni, duke përfshirë edhe ato ligjore, nëpërmjet rrejtit të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor kryesisht në nivel komunitar, mbështetje sociale për akomodimin dhe funksionimin në komunitet nga ana e pushetit lokal; nëpërmjet mekanizimeve të ndryshëm, etj)	Mars – Qershor 2022	MD; MSHMS
2.12	Sigurimi i trajnimit të vazhdueshëm për tema të ndryshme të psikiatriisë ligjore të stafit multidisiplinar	Në vazhdimësi	MD; MSHMS
3. INSTITUCIONI MJEKËSOR I POSAÇËM (PËRHERSHËM)			
3.1	Përfshirja e projekt – ffishës për ngritjen dhe funksionimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm në Përgjigjen Strategjike të IPA III apo financime të tjera ndërkombëtare (ËBIF, etj.)	2022	MSHMS
3.2	Miratimi në parim i projekt – ffishës nga pala financuese ndërkombëtare nëpërmjet ndërmjetësimit të MEPJ	2023 – në vazhdimësi	MSHMS

3.3	Maturimi i fshës së projektit për ngritjen dhe funksionimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm nëpërmjet shkrimit të “Action Document” dhe realizimi i studimit të fizibilitetit dhe projekt – dizajnit paraparak	2023 – në vazhdimësi	MSHMS
3.4	Miratimi/dakordësia për financimin e projektit dhe procedurat e financimit nga strukturat financuese evropiane dhe zbatimi i tij	2023 – në vazhdimësi	MSHMS
3.5	Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së Komunikimit në lidhje me Institucionin Mjekësor të Posaçëm, si strukturë e dedikuar, duke përfshirë adresimin e shqetësimeve të komunitetit	2023 – në vazhdimësi	MSHMS
3.6	Rishikim. dhe përditësimi i dokumentave të hartuara për funksionimin e strukturës tranzitore (rregulloret, PSV-të, protokollin e sigurisë, marrëveshja e bashkëpunimit, plan kujdesi të vazhdueshëm në nivel komunitar, etj)	2023 – në vazhdimësi	MSHMS
3.7	Rishikim. i strukturës së burimeve njerëzore dhe rekrutimi i personelit shesë, klinik dhe/ose administrativ, të nevojshëm për funksionin optimal të strukturës së dedikuar duke reflektuar nevojat e kohës	2023 – në vazhdimësi	MSHMS
3.8	Realizimi i procedurës së transferimit të pacientëve në Institucionin Mjekësor të Posaçëm nga struktura tranzitore Lezhë, përfshirë informimin e stafit si dhe të pacientëve dhe familjarëve për planet e zhvillimit	2023 – në vazhdimësi	MD; MSHMS